



Drejtoria për Shërbime Publike
Odeljenje za Opštinske Javne Usluge
Department of Municipal Public Services

Nr. I prot. 903
Br. prot. 08-03-2023
Më 08-03-2023
RAHOVEC - ORAHOVAC

Datë/Datum/Date:	08.03.2023
Referenc-ë	
Për/Za/To:	Kuvendin e Komunës së Rahovecit
CC:	
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	z.Përparim Krasniqi, Drejtor për Shërbime Publike
Subjekti/Predmet/Subject:	Informatë

Informatë mbi implementimin e projektit të mirëmbajtjes dimërore të rrugëve në Komunën e Rahovecit

Komuna e Rahovecit ka kontraktuar 3 kompani për mirëmbajtje të rrugëve gjatë sezonës dimërore dhe verore.

1. Periudha dimërore llogaritet nga data 15 nëntor deri me 15 mars të vitit që vie,
2. Periudha verore llogaritet nga 15 marsi i atij vitit deri me 15 nëntor.

Gjatë sezonës dimërore parashihen të mirëmbahen rrugët nga bora dhe akulli, si dhe hedhja e kripës industriale, ndërsa momentin që nuk ka borë kompanitë janë të detyruar të bëjnë pastrimin e rrugëve nga mbeturinat.

Ndërsa gjatë sezonës verore parashihen të mirëmbahen rrugët duke përfshirë larjen dhe pastrimin e brezave rrugore dhe trotuareve.

Sa i përket mirëmbajtjes dimërore të rrugëve komuna e Rahovecit e ka ndare në 3 zona mirëmbajtje të rrugëve lokale;

Lot-1, 173,464,13 euro, KRM Ekoregjioni, janë keto segmente rrugore me gjatësi 71 km, ku përfshihet qyteti i Rahovecit me 106 segmente rrugore.

Lot-2, 214,503.67 euro, Eko Drinia, janë keto segmente rrugore me gjatësi 192 km, ku përfshihen 24 vendbanime.

Lot-3, 73,784.72 euro, Berisha Com, janë keto segmente rrugore, me gjatësi 68 km, ku janë të përfshira gjithsej 9 vendbanime.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Shërbime Publike
Adresa: 8 Dëshmorët e Pashtrikut – p.n. Rahovec, Kosovë
Tel: +383 29 276 943
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>

Projekti i mirëmbajtjes së hapësirave publike

Projekti i mirëmbajtjes së hapësirave publike është i specifikuar në kontratat e komunës së Rahovecit ku në masë të madhe janë të përfshira të gjitha hapësirat tjera duke përfshirë, varreza civile, varreza të Dëshmoreve, lapidare, vegjetacione, breza rrugore apo trotuare, përveq kësaj duke pasur parasysh që komuna e Rahovecit kufizohet edhe me rrugë rajonale, shumë shpesh ka ndodhur që komuna ka mirëmbajtur edhe këto rrugë.

Ne çdo vit ka ndryshime në pozicione të caktuara, specifikisht risi është edhe larja dhe lysterja e lapidareve dhe shtatoreve që janë të vendosur në territorin e komunës së Rahovecit.

Për me shume detaje dhe sqarime tjera, do te jemi te hapur te diskutojmë gjate mbledhjes se KPF-së dhe Mbledhjes së Kuvendit të komunës.

Me respekt,

Drejtoria e Shërbimeve Publike

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Shërbime Publike
Adresa: 8 Dëshmorët e Pashtrikut – p.n. Rahovec, Kosovë
Tel: +383 29 276 943
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>